



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KRYETAR**

Nr. 12355 prot.

Shkodër, më 06.09. 2023

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendim dhe relacion.

Këshillit Bashkiak Shkodër

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur ju dërgojmë për shqyrtim relacion dhe projekt-vendim :

“PËR CAKTIMIN E DISA KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONIN QË VENDOSËT PËR TO, NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË SHKODËR”

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt!

KRYETAR
Beqir BECI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KRYETAR**

Nr. ____ prot.

Shkodër, më ____ . ____ . 2023

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ . 2023

**“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR CAKTIMIN E DISA
KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONIN QË
VENDOSËT PËR TO NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË
SHKODËR”**

Këshilli Bashkiak Shkoder në mbledhjen e tij të datës ____ / ____ . 2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin nr 8419, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; Nenin 54, shkronja “k” të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar; Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”; Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë; Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Ligjin nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”; Ligjin nr. 10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” të ndryshuar ; Ligjin nr. 8094 datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”; Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar; Ligjin nr.9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” të ndryshuar; Ligjin nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuar; Ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; VKM nr.171 datë 27.03.2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” të ndryshuar”; VKM nr. 402, datë 30.6.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”; VKM nr.1096, datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”; VKM nr. 447, datë 16.6.2010 “ Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”; VKM nr. 475, datë 30.7.2021 “Për bashkëpunimin e njësive të vetëqeverisjes vendore me shërbimin veterinar”; Udhëzimin nr.5, datë 26.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis”; Urdhër nr.935 datë 17.08.2023 ”Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e rregullores për caktimin e disa kundërvajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e bashkisë Shkodër” dhe sipas relacionit nr _____, datë ____ . ____ . 2023, të përgatitur nga administrata e bashkisë Shkodër;

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për caktimin e disa kundërvajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin administrativ të bashkisë Shkodër”, sipas materialit bashkëngjitur, pjesë integrale e këtij vendimi.
2. Kjo rregullore zbatohet me ndryshimin e paketës fiskale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.



KRYETAR
Berret BECI

Zv. Kryetar

Orjola Bejleri

Drejtorja e te Ardhurave

Okje Princi

Drejtorja e Financës

Blerta Gjergjezi

Drejtorja e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve

Erjon Dikaveri

Drejtorja e Shërbimeve Publike, Investimeve dhe Infrastrukturës

Alfred Suleta

Drejtorja e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit

Arben Bardhi

Drejtorja e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave

Giada Shllaku

Drejtorja Juridike

Edhema Legge

Drejtorja Bujqesise, zhvillimit Rural dhe AMTP

Alban Selço



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____, 2023

RELACION

“PËR CAKTIMIN E DISA KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONIN QË VENDOSËT PËR TO, NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË SHKODËR”

Drejtuar: Këshillit Bashkiak, Shkodër

Të nderuar këshilltarë!

Bashkia Shkodër në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë dhe funksioneve të saj cakton rregulla për organizimin dhe funksionimin e çeshtjeve vendore brenda juridiksionit të saj, në pajtim me ligjin. Në referim të parimeve kushtetuese dhe ligjore kemi marrë këtë nisëm për të hartuar rregulloren “Për caktimin e disa kundërvajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin administrativ të bashkisë Shkodër”.

Qëllimi i kësaj rregullore është sigurimi i rendit dhe qetësisë, mbrojtja e pronës publike, garantimi dhe zbatimi i rregullave, normave detyruese të higjenës, shëndetit publik dhe etikës të përcaktuara në legjislationin në fuqi dhe aktet normative të Bashkisë Shkodër, duke u angazhuar në ndërgjegjësimin nga të gjithë, për respektimin e rregullave të bashkëjetesës shoqërore, nëpërmjet përcaktimit të kundërvajtjeve administrative që cënonjë këto rregulla në fushën e sigurisë, qetësisë, moralit publik, mbrojtjes së mjedisit dhe hapësirës publike, me perjashtim të veprimtarive që kontrollohen nga organet e tjera të përcaktuara me ligje sektoriale.

Një nder funksionet e Bashkisë, përcaktuar në nenin 23 të Ligjit nr 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar, janë edhe “Funksionet në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike” në territorin e juridiksionit tonë sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Në ushtrim të këtij funksioni dhe në zbatim të Ligjit Nr 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; i ndryshuar, Ligj nr. 10 279, datë 20.5.2010 Për kundërvajtjet administrative, VKM. Nr. 1096 datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”; VKM nr. 686, datë 22.11.2017, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, të ndryshuar, hapësira publike është pronë e përbashkët, që i përket komunitetit ku jetojmë, dhe të gjithë ne jemi të barabartë kundrejt përdorimit të saj. Në këto kushte është e nevojshme që të përcaktohet përmes një Rregulloreje, se cilat janë rregullat për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative në fushën e përdorimit, shfrytëzimit dhe menaxhimit të hapësirave publike.

Në këto kushte, zënia e hapësirave publike në territorin e Bashkisë përkohësisht ose në mënyrë të përheshme pa lejen apo autorizimin e saj kur nuk përbën vepër penale, përbën kundravajtje administrative. Në rastin e zënies së hapësirës publike në kundërshtim me rregullat e vendosura nga Bashkia e Shkodrës strukturat konstatuese, veprojnë në përputhje me sanksionet administrative të percaktuara në këtë rregullore.

Pjesë e këtij funksioni me një rëndësi të vecantë është edhe Mbledhja , Largimi dhe Trajtimi i mbetjeve të ngurta shtëpiake, në funksion të këtij shërbimi është Ligji Nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar si edhe aktet nënligjore në funksion të këtij ligji por edhe ligje të tjera sektoriale si Ligji nr.10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”i ndryshuar etj, përveç masave/sanksioneve të cilat ngarkojnë organet e tjera për marrjen e masave dhe vendosjen e sanksioneve, detyrojnë edhe njësitë e vetqeverisjes vendore që të miradministrojnë këto shërbime. Duke vlerësuar maksimalisht këtë shërbim si shumë të rëndësishëm , në këtë rregullore janë përcaktuar kundravajtjet administrative dhe sanksionet në këtë fushë.

Ligji sektorial nr.8102/1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit të ujrave të ndotura”, aktet nënligjore në funksion të tyre, funksionin e ndricimit publik, përveç masave/sanksioneve të cilat ngarkojnë organet e tjera bazuar në këto ligje, detyrojnë edhe njësitë e vetqeverisjes vendore që të miradministrojnë këto të mira kombëtare nëpërmjet funksioneve të tyre.

Një tjetër funksion i Bashkisë të përcaktuar në nenin 26 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar, është “Sigurimi në nivel vendor i masave për mbrojtjen nga ndotja akustike”. Ligji sektorial nr 9774/2007 “Për administrimin e zhurmës në mjedis” , u ndryshua me Ligjin nr 50/2023. Ky ndryshim ligjor bëri një ndarje më të qartë të kompetencave midis institucioneve qendrore dhe vendore për monitorimin e nivelit të zhurmës në zona publike apo të gjeneruar nga veprimtari ekonomike ose sociale, si dhe dhënien e miratimeve për zhvillimin e aktiviteteve që lëshojnë zhurmë në mjedis, duke siguruar që zhurma e lejuar të jetë brenda vlerave kufi.

Monitorimi dhe parandalimi i lëshimit të zhurmës mbi vlerat kufi, si një masë për parandalimin e mbrojtjes së mjedisit dhe njerëzve nga zhurmat e bezdishme propozojmë që të jenë pjesë e Kundravajtjeve Administrative duke u shoqëruar edhe me sanksione të percaktuara në këte rregullore.

Një tjetër funksion i Bashkisë të përcaktuar në nenin 29 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar , janë edhe “ Funksionet në fushën e sigurisë publike”. Pjesë e këtij funksioni me një rëndësi të vecantë janë garantimin e mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në komunitet. Parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të njërive të vetqeverisjes vendore brenda juridiksionit të vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore.

Ligji sektorial në funksion të këtij shërbimi është Ligjit nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”,por edhe ligje të tjera sektoriale të cilat detyrojnë njësitë e vetqeverisjes vendore që të jenë përgjegjëse dhe të garantojnë këto funksione.

Duke vlerësuar maksimalisht këto funksione si shumë të rëndësishëm , në këtë rregullore janë përcaktuar kundravajtjet administrative dhe sanksionet në këtë fushë.

Kjo rregullore është hartuar në referim të dispozitave ligjore të parashikuara në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”; Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Ligjit nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”; Ligjin nr.10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” të ndryshuar; Ligjin nr.8094 datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”; Ligjin nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar; Ligjin nr.9774 datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” të ndryshuar; Ligjin nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuar; Ligjin nr.10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; VKM nr. 686, datë 22.11.2017, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, të ndryshuar; VKM nr.402, datë 30.6.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”; VKM nr.1096, datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”; VKM nr.447, datë 16.6.2010 për “Miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”; VKM nr.475, datë 30.7.2021 “Për bashkëpunimin e njësive të vetëqeverisjes vendore me shërbimin veterinar” ; Udhëzimin nr.5, datë 26.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis”; Urdhër nr.935 datë 17.08.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e rregullores për caktimin e disa kundërvajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e bashkisë Shkodër”

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 54 germa “k”, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshur; **PROPOZJMË**;

Këshillit të Bashkisë Shkodër, miratimin e projekt-vendimit “Për caktimin e disa kundërvajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to, në territorin administrativ të bashkisë Shkodër”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Grupi i punës

z.Onid Bejleri - Kryetar
zj.Blerta Mjeda - anetare
zj.Aida Shllaku - anetare
zj.Ina Xhakoni - anetare
zj.Lorena Bardeli - anetare
zj.Elma Piraniqi - anetare
z.Erjon Dilaveri - anetar
z.Pjerin Lazri - anetar
z.Halit Bilali - anetar



KRYETAR

Benet BECI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

RREGULLORE
“PËR CAKTIMIN E DISA
KUNDËRVAJTJEVE
ADMINISTRATIVE DHE
SANKSIONIN QË VENDOSSET PËR
TO NË TERRITORIN
ADMINISTRATIV TË BASHKISË
SHKODËR”

PËRMBAJTJA

“REGULLORE PËR CAKTIMIN E DISA KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONIN QË VENDOSËT PËR TO NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË SHKODËR”	1
KREU I	3
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	3
KREU II.....	5
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE	5
KREU III	11
SANKSIONET ADMINISTRATIVE DHE MËNYRA E CAKTIMIT TË TYRE	11
KREU IV	14
KOMPETENCAT DHE PROCEDURA E KONSTATIMIT DHE SHQYRTIMIT TË KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE DHE ZBATIMI I TYRE.....	14

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Baza Ligjore

Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar ;
Ligji nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar;
Ligji nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
Ligji nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr.68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”;
Ligji nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”;
Ligji nr.10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” të ndryshuar;
Ligji nr. 8094 datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”;
Ligji nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar;
Ligji nr.9774 datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” të ndryshuar;
Ligji nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuar ;
Ligji nr.10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar
VKM-së nr.171 datë 27.03.2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, të ndryshuar;
VKM nr.402, datë 30.6.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve” ;
VKM nr.1096, datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”;
VKM nr.447, datë 16.6.2010 për “Miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”;
VKM nr. 475, datë 30.7.2021 “Për bashkëpunimin e njësisë të vetqeverisjes vendore me shërbimin veterinar” ;
VKM nr. 686, date 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, të ndryshuar
Udhëzimin nr.5 datë 26.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis”;

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti dhe qëllimi

- 1.Ky vendim ka si synim përcaktimin e rregullave të përgjithshme dhe normative sjellje, si dhe standarte të detyrueshme për t’u zbatuar nga çdo subjekt juridik e individ fizik, që ushtrojnë aktivitetin e tyre apo të jetojnë në Bashkinë e Shkodrës.
- 2.Ky vendim përcakton kundërvajtjet administrative për shkelje të rregullave, normave detyruese të higjenës, shëndetit publik dhe etikës së bashkëjetesës shoqërore, në fushën e sigurisë publike, qetësinë dhe moralin publik, mbrojtjes së mjedisit, hapësirës publike, si dhe procedurën e konstatimit të kundërvajtjes dhe vendosjes së sanksioneve administrative për to.
- 3.Qëllimi i këtij vendimi është sigurimi i rendit dhe qetësisë, mbrojtja e pronës publike/shtetërore, garantimi dhe zbatimi i rregullave, normave detyruese të higjenës, shëndetit publik dhe etikës të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe aktet normative të Bashkisë së

Shkodrës, duke u angazhuar në ndërgjegjësimin nga të gjithë, për respektimin e rregullave të bashkëjetesës shoqërore, nëpërmjet përcaktimit të kundërvajtjeve administrative që cënonjë këto rregulla në fushën e sigurisë, qetësisë, moralit publik, mbrojtjes së mjedisit dhe hapësirës publike.

Neni 2 Përkufizime

Në këtë vendim, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

1. **“Strukturë konstatuse”**, është çdo punonjës i strukturave të Bashkisë së Shkodrës që ka për detyrë funksionale konstatimin dhe dënimin e kundërvajtjeve administrative, sipas fushës së përgjegjësi që mbulon, i cili mund të jetë punonjës i Policisë Bashkiake, Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore apo çdo strukturë tjetër të ngarkuar nga Kryetari i Bashkisë.
2. **“Bashkëjetesa shoqërore”**, është tërësia e normave që përcaktojnë sjelljen/marrëdhënien e individëve në shoqëri, me qëllim ruajtjen e ekuilibrave të bashkëjetesës, nëpërmjet zbatimit të rregullit social, mbrojtjes së lirive dhe të drejtave individuale, sigurisë së jetës dhe veprimtarive të përditshme ekonomike-shoqërore, përfshirë këtu edhe bashkëpronësinë në ndërtesat e banimit.
3. **“Funksion i Bashkisë Shkodër”**, është fusha e veprimtarisë, për të cilën Bashkia si njësi e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse dhe ka kompetencë ligjore për ta ushtruar lirisht, tërësisht apo pjesërisht në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore, sipas parashikimeve të ligjit 139/2015, përfshirë këtu lëshimin e lejeve, licencave dhe autorizimeve përkatëse.
4. **“Hapësirë publike dhe hapësirë në bashkëpronësi”**, janë hapësira si trotuare, rrugë, sheshe, lulishte, parqe, shëtitiore, shesh pushime shkallësh në pallate, rrugë kalime e mjedise të tjera në përdorim publik, përveçse përmes dokumentave të planifikimit, të parashikuar nga ligji.
5. **“Veprim”**, është çdo veprim i caktuar, i natyrës tregtare, ekonomike, profesionale apo çdo veprim tjetër i ngjashëm, apo sjellja e natyrës vetjake e çdo qytetari/individit, i cili kryhet gjatë ushimit të një veprimtarie, që liçenohet apo jo, ose gjatë përdorimit të një të mirë publike, që i nënshtrohet apo jo pajisjes me leje.
6. **“Liçencë, leje, autorizim”**, është akti administrativ, që i njuh çdo subjekti apo individit të drejtën të fillojë e të ushtrojë tipin e veprimtarisë, të drejtën për të kryer një apo disa veprime në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.
- 7 **“Sanksionet administrative janë akte adminisitrative që lëshohen ndaj subjekteve nga strukturat konstatuese si rrjedhojë e shkeljes administrative të konstatuar.**

Neni 3 Parimet Bazë

- 1.Parimet themelore në bazë të të cilave udhëhiqet Bashkia e Shkodrës dhe çdo strukturë e saj në veprimtarinë e tyre janë : Ligjshmëria, mosdiskriminimi, mbrojtja e të dhënave personale, paanësia dhe parimi i drejtësisë, mbrojtja dhe garantimi i interesit publik dhe jetës e shëndetit të qytetarëve, kontrolli dhe llogaridhënia.
- 2.Ushtrimi i një veprimtarie apo kryerja e një veprimi të caktuar në territorin e Bashkisë së Shkodrës, përfshirë këtu miratimet apo autorizimet përkatëse, të cilat bëhen vetëm nëse :
 - a. Ushtrimi i veprimtarisë apo kryerja e veprimit në mënyrë të parregullt nuk cënon apo mund të cënojë jetën, shëndetin, të drejtat dhe interesat e ligjshme të shtetasve, sigurimin e rendin publik në të mirë publike, objektiva sociale dhe cdo interes tjetër publik dhe qytetar të kësaj natyre.

Neni 4
Misioni dhe detyrat e strukturës konstatuese

1. Struktura konstatuese, në varësi të Bashkisë së Shkodrës, në përmbushje të misionit dhe sipas fushës së kompetencave të tyre kanë si mision ruajtjen dhe garantimin e zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore nga kryerja e veprimeve dhe/ose mosveprimeve të kundërligjshme në fushën e infrastrukturës, shërbimeve publike, shërbimeve sociale, kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese, mbrojtjes së mjedisit, hapësirës publike, si dhe në fushën e zhvillimit ekonomik vendor dhe sigurisë publike.
2. Çdo strukturë konstatuese, ka si detyrë të monitorojë, kontrollojë e marrë masat në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, për zbatimin e rregulloreve, urdhërave e udhëzimeve të miratuara nga Këshilli Bashkiak apo Kryetari i Bashkisë, për probleme që lidhen me zbatimin e këtij vendimi apo përmbushjen e funksioneve të Bashkisë si një njësi e vetëqeverisjes vendore.

Neni 5
Bashkëveprimi me strukturat e tjera

Në përmbushje të misionit dhe realizimit të detyrave, strukturat konstatuese të Bashkisë së Shkodrës, sipas rastit dhe nevojës bashkëpunojnë dhe bashkëveprojnë me strukturat dhe institucionet e tjera shtetërore.

KREU II
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 6
Veprimtaria e lejuar në territorin e Bashkisë Shkodër

1. Në territorin e Bashkisë Shkodër, përfshirë këtu hapësirat publike dhe ato private, lejohen të kryhen vetëm aktivitete dhe veprimtari që janë në përputhje me qëllimin e kryerjes së tyre, duke respektuar funksionin, kushtet e përdorimit dhe shërbimet e lejuara, sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe të përcaktuara e të rregulluara në akte administrative dhe normative të nxjerra nga Bashkia Shkodër apo strukturat përgjegjëse të saj, nëpërmjet lëshimit të lejeve, autorizimeve dhe miratimeve përkatëse nga këto të fundit.
2. Çdo veprimtari apo aktivitet që ushtrohet në territorin e Bashkisë Shkodër, duhet të paiset me lejet dhe autorizimet përkatëse të lëshuara nga ky institucion, kur është në kompetencën e saj. Pavarësisht lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga entet publike shtetërore sipas fushës së kompetencave të tyre, çdo veprimtari apo aktivitet që zhvillohet apo synohet të zhvillohet në kundërshtim me këtë vendim, kriterëve dhe rregullave të përcaktuara nga Bashkia e Shkodrës, dënohet në mënyrë administrative dhe merren masa deri në mbylljen e aktivitetit që ushtrohet.

Neni 7
Zënia në kundërshtim me rregullat e hapësirës publike

1. Ndalohet zënia e hapësirës publike dhe hapësirave mbi dhe nën to, në territorin e Bashkisë së Shkodrës, qoftë edhe përkohësisht, me çfarëdo lloj sendi apo objekti pa lejen apo autorizimin e bashkisë apo strukturës përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e tyre.
2. Zënia e hapësirës publike, veprimi apo mosveprimi në kundërshtim me rregullat e miratuara nga Bashkia Shkodër dhe legjislacioni në fuqi, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet sipas këtij vendimi, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore për kundërvajtjet administrative.

3.Në rastin e zënies së hapësirës publike në kundërshtim me rregullat e vendosura nga Bashkia e Shkodrës apo në rastet kur subjekti ushtron ose zhvillon aktivitetin në këto hapësira publike pa lejen përkatëse, strukturat konstatuese, vepron në përputhje me sanksionet administrative të parashikuara në nenet 17 dhe 18 të këtij vendimi.

4.Në rastin kur subjekti kundërvajtës rezulton, se është i padënuar në mënyrë administrative për shkeljen e konstatuar, atëhere struktura konstatuese vepron duke vendosur fillimisht dënimin administrativ “Paralajmërim me shkrim” , sipas nenit 17, pika 1, shkronja “a” e këtij vendimi

5.Në rastin kur, subjekti vijon të kryejë aktivitetin apo rezulton të jetë përsëritës i të njëjtës shkelje administrative, struktura konstatuese vendos dënimin me gjobë, duke mbajtur në konsideratë rrethanat lehtësuese dhe rënduese, sipas parashikimeve të këtij vendimi.

6. Subjekti ambulant, i cili refuzon të identifikohet apo në rastet kur struktura konstatuese e ka të pamundur identifikimin e tij, ka të drejtën të kërkojë ndihmën e Policisë së Shtetit për kryerjen e kontrollit të identitetit të personit që ka kryer kundërvajtjen administrative.

7.Në rastin e kundërvajtësit, identifikimi i të cilit nuk mund të bëhet, Policia Bashkiake liron hapësirën publike dhe e pasqyron në procesverbal bllokimin e mallit dhe ruajtjen e tij me një afat kohor prej 48 orësh nga momenti i konstatimit të kundërvajtjes administrative. Procesverbali/akt konstatimi përpilohet dhe nënshkruhet konform pikës 1 të nenit 13 dhe pikës 1 e 2 të nenit 14 të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

8.Me paraqitjen e dokumentave identifikues dhe kryerjen e procedurës përkatëse administrative, Policia Bashkiake nëpërmjet mbajtjes së procesverbalit përkatës, bën zhbllokimin dhe ja dorëzon mallin e bllokuar subjektit kundërvajtës.

9.Pas kalimit të afatit të parashikuar në pikën 7 të këtij neni, Policia Bashkiake, me urdhër të drejtuesit të Policisë Bashkiake ngre një komision të përbërë prej jo më pak se tre punonjës për asgjësimin e mallit të bllokuar. Çdo veprim i komisionit dokumentohet me procesverbalin përkatës të asgjësimit.

10.E njëjta procedurë ndiqet nga Policia Bashkiake edhe në rastin kur kundërvajtësi është i identifikueshëm, por ushtron aktivitetin dhe zënen e hapësirës publike në mënyrë të paautorizuar nga strukturat përkatëse.

Neni 8

Kundërvajtjet administrative në fushën e sigurisë

Për aq sa nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e sigurisë publike, këto veprime:

a. Zënia e hapësirave publike, si trotuarëve, rrugës dhe rrugëkalimeve që pengojnë lëvizjen për qytetarët dhe mjetet lëvizëse, pa miratimin e strukturës përgjegjëse.

b. Hedhja e objekteve dhe sendeve të forta, që pengojnë zhvillimin normal të veprimtarive sociale kulturore, kreative apo promovuse që zhvillohen në hapësirat publike.

c. Përdorimi i banderolave dhe thirrjeve me përmbajtje fyese apo denigruese gjatë zhvillimit të aktiviteteve apo veprimtarive sportive, kulturore, fetare, artistike, si dhe gjatë zhvillimit të tubimeve dhe manifestimeve.

ç. Braktisja e automjeteve dhe sendeve të tjera në rrugë, mjedise publike apo ambiente të përbashkëta.

d. Cënimi nëpërmjet bërjes së grafitëve ose shkrimeve, ndotjes me substanca të ndryshme apo gërvishtja e ndërtesave publike apo private, përveç rasteve kur kryhet në kuadër të veprimtarive artistike dhe me miratimin e strukturës përgjegjëse.

e. Vendosja me ngjitje, kapsim apo çdo mënyrë tjetër, e afisheve apo posterave e reklamave të ndryshme, në ndërtesat private apo publike, pa miratimin e strukturës përgjegjëse.

f. Kryerja e veprimeve apo mosveprimeve, që vënë në rrezik jetën, shëndetin, pronën, apo pronën e të tjerëve përmes mungesës së mirëmbajtjes së njësisë/prones individuale nga pronari i

njesisë i cili është i detyruar ta mirembaje njësinë me shpenzimet e veta, vendosjes pa masa sigurie të vazove të luleve apo çdo send tjetër në parvazet e dritareve, ballkoneve, në tarraca apo në çdo pjesë tjetër të mjedisve publike, të përbashkëta apo private. Me mirembajtjen e njesisë individuale, asnje pronar nuk duhet të cenojë, të demtojë apo të rrezikojë pronën e përbashkët apo pronën e një pronari tjetër.

g. Përdorimi i lëndëve piroteknike apo fishekzjarrëve në çdo mënyrë që vë në rrezik shëndetin, jetën, pronën apo ambientin, në kundërshtim me legjislacionin për përdorimin e tyre.

h. Lëvizja e mjeteve motorike në orët dhe vendet e rezervuara për këmbësorët, biçikletat, etj.

i. Zënia e vendparkimit të dedikuar për persona me aftësi të kufizuar (PAK), për automjetet taksi, si dhe automjete të tjera të shërbimit publik e privat.

j. Dëmtimi i mjediseve publike apo të përbashkëta, duke mos u ndalur vetëm në të: shkallët, fasadat e pallateve, lulishte, stola, shatërvanë, monumente, statuja dhe kënde lojërash, etj.

k. Vendosja e pengesave të çfarëdo lloji për kufizimin e shpejtësisë së lëvizjes së automjeteve, si dhe ndërtimi i objekteve përkujtimore përgjatë rrugës pa miratimin e organit përgjegjës publik.

l. Kryerja e çfarëdo lloj aktiviteti në afërsi dhe pranë rrugëve, që rrezikon sigurinë rrugore, jashtë normave të sigurisë të përcaktuara nga Kodi Rrugor dhe pa miratimin e organit përgjegjës publik.

m. Zënia e vend parkimeve publike dhe vendeve ku lejohet parkimi në hapësirat pranë blloqeve të banesave me automjete me qëllim ekspozimin/tregtimin e tyre apo qëllime të tjera biznesi.

n. Qarkullimi me mjete motorike, biçikleta në shëtitore, plazhe, parqe apo vende pushimi për qytetarët në orët e ndaluara sipas rregullave rregullave dhe legjislacioni në fuqi.

o. Ndalimi/pushimi/qëndrimi i mjeteve motorike në Rrugët “ 13 Dhjetori”; “ 28 Nëntori”, “Kolë Idromeno”, dhe “Gjuhadol”.

Neni 9

Kundërvajtjet administrative në fushën e qetësisë publike dhe normave detyruese të bashkëjetesës

1. Për atë që nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e qetësisë publike dhe normave detyruese të bashkëjetesës, këto veprime:

a. Shkaktimi i zhurmave shqetësuese nga punimet/ndërtimet në mjedise publike e private, të kryera jashtë orareve të përcaktuara nga rregullat e fqinjësisë së mirë, apo pa miratimin e organit përgjegjës publik.

b. Krijimi i zhurmave shqetësuese, në zonat e banuara nëpërmjet borive, megafonëve, atopolantëve dhe shkaktuar nga njerëzit brenda apartamenteve, banesave, etj.

c. Djegia e mbeturinave apo ndezja e zjarrit në zonat e banuara, përgjatë vijës bregdetare, lulishte apo parqe në vende të papërcaktuara për këtë qëllim dhe pa lejen e strukturës përgjegjëse.

d. Përdorimi i materialeve apo sendeve të ndryshme imituese, tymuese, rezeve lazer në ambientet e hapura dhe të mbyllura publike.

e. Lëvizja me kafshë/e kafshëve (kuaj, gomerëve, etj) në mjedise publike në qendrat urbane, parqe, plazhe përgjatë vijës bregdetare, lulishte në vende të pamiratuara për këtë qëllim nga organi përgjegjës publik.

Neni 10

Kundërvajtjet administrative kundër normave të sjelljes

Për atë që nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e normave të sjelljes, këto veprime:

a. Dalja zhveshur ose pjesërisht të zhveshur, (duke ekspozuar pjesët intime) në mjediset publike.

b. Urinimi, defektimi apo të pështyrja në mjedise publike.

- c. Të bërtiturit me fjalë apo shprehje vulgare apo kryerja e veprimeve me gjeste vulgare në mjediset publike.
- ç. Veprimet apo sjelljet e çdo natyre që kanë për qëllim ngacmimin, fyerjen apo talljen ndaj njerëzve me afësi të kufizuara, të moshuarve dhe personave të mitur, etj.
- d. Dehja në mjediset publike, kur shoqërohet me veprime që krijojnë shqetësim për qytetaret e tjerë dhe pengojnë aktivitetin normal të tyre.

Neni 11

Kundërvajtjet administrative në fushën e mjedisit

1. Për atë që nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e mjedisit, këto veprime:

- a. Dorëzimi (hedhja) e mbetjeve urbane jashtë kontenierëve dhe jashtë pikave të Grumbullimit (PGM);
- b. Djegia e mbetjeve urbane në konteneirë, në PGM'të në territore publike dhe private brenda territorit të Bashkisë Shkodër;
- c. Dorëzimi (hedhja) ditore e mbetjeve urbane në kontenierë, në një volum më të madh se 1/4 e volumit të një kontenieri publik;
- d. Ndotja me dhe e baltë e rrugëve dhe trotuarëve gjatë transportit ose punimeve në kantierët e ndërtimit;
- e. Dorëzimi (hedhja) e mbetjeve të castit, ambalazhet, mbetjet e ngurta, organike etj në hapsirat publike, trotuarë, rrugë, lulishte plazhe etj;
- f. Dorëzimi (hedhja) e mbetjeve të ngurta urbane në koshat e vegjël që janë të destinuar vetëm për mbetje të castit nga kalimtarë turistë apo vizitorë .
- g. Dorëzimi (hedhja) mbetjeve të ngurta, apo mbetjeve nga shërbimi I pastrimit, në pusetat e elektrikut, ujësjellësit, basen nenujore, etj;
- h. Moskryerja e pastrimit të territorit apo vendit të punës mbas mbarimit të aktivitetit ,për tregjet apo tregëtarët ambulantë para lokaleve apo vendit të punës në gjerësi 2-5 m.
- i. Hedhja ,derdhja në trotuare e ujrave dhe mbetjeve të ndryshme nga pastrami apo larja e lokaleve të shërbimit , dyqaneve etj;
- j. Dorëzimi (hedhja) e mbetjeve në kontenierë /PGM në ditë dhe orare të ndryshme nga ato të përcaktuara nga Bashkia;
- k. Dorëzimi I pasistemuar, i paplotësuar, apo i pambyllur i mbetjeve tregtare, si dhe mosdorëzimi i tyre në pikat e grumbullimit të përcaktuara nga Bashkia;
- l. Shkarkimi, depozitimi i mbetjeve nga makinat e madhësive të ndryshme në territore publike Brenda territorit të Bashkisë;
- m. Dorëzimi(hedhja) e mbetjeve të vëllimshme,mbetjeve të ndërtimit apo kontenierëve apo në vendet e grumbullimit të mbetjeve urbane;
- n. Kryerja e selektimit manual , kërkimit apo marrje të mbetjeve të dorëzuara në kontenierë , etj nga persona të pa autorizuar;
- o. Dorëzimi (hedhja) në kontenierë apo në mjetet e përdorura për grumbullimin e mbetjeve , i mbetjeve të lëngëta,meqese të zgjidhura apo jo të lidhura mirë,e substancave të ngrohta, ndezëse, të rrezikshme, e mbetjeve spitalore, apo kafshëve të ngordhura për mëtepër mbetje të forta (inerte) që mund të dëmtojnë kontenierin ose përbëjnë rrezik për komunitetin;

- p. Dorëzimi (hedhja) e mbetjeve nga aktivitet e prodhimi , përpunimi, trajtimit, industrial etj, si dhe mbetje të papranueshme të përcaktuara në rregullore, në kontenierët publik apo në PGM;
- q. Ndryshimi abuziv i PGM-eve apo konteniereve, sipas vendodhjeve të përcaktuara nga Bashkia;
- r. Parkimi i mjeteve para ose pranë pikave të grumbullimit të mbetjeve ose në hapësirat e manovrimit të mjeteve të pastrimit;
- s. Hedhja e mbetjeve të krasitjeve të pemeve, mbetjet nga punimet në kopshtari, korrja e barit etj mbi volumin e përcaktuar, jashtë kontenierit të përcaktuar për këtë qëllim ose jashtë ditëve dhe orareve të përcaktuar nga Bashkia;
- t. Dëmtimi i pjesshëm apo total i kontenierit dhe vjedhja e kontenierit ose përvetsimi nga individë apo biznese.

2. Kryerja e aktivitetit, për të gjitha veprimtaritë që për shkak të natyrës së tyre prodhojnë zhurmë mjedisore, erëra të pa këndshme, si dhe përdorimin e mjeteve e paisjeve që shkaktojnë keto lloje ndotjesh mjedisore dhe jo vetem, si:

- Furra të prodhimit të bukës/ gatimi dhe tregtimi i produkteve ushqimore të gatshme dhe gjysëm të gatshme/ bare, restorante/ njësi shërbimi/ gomisteritë/ lavazhet apo serviset që riparojnë mjetet dhe aktivitete të tjera.

3. Kontrollit me pajisje të certifikuara për matjen e niveleve të zhurmës, të personave fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari që lëshojnë zhurmë, si dhe marrjen e masave administrative, pezullimin apo mbylljen e veprimtarive, që nuk respektojnë dispozitat e këtij ligji, me përjashtim të veprimtarive që kontrollohen nga organet e tjera të përcaktuara në këtë ligj;

4. Shkelje të kryera në fushën e ndërtimit dhe të veprimeve në funksion të saj, të shkaktuara nga subjektet ndërtues/investitorë, për kryerjen e veprimeve të mëposhtme:

- a. Ndotje e hapësirës publike nga gomat dhe pajisjet e automjeteve të tipeve dhe tonazheve të ndryshme, të cilat dalin nga kantieri i ndërtimit pa marrë masat për pastrimin e tyre.
- b. Ndotje të hapësirës publike jashtë rrethimit të kantierit të ndërtimit, nga inerte apo materiale të tjera ndërtimore.
- c. Krijimi i ndotjeve të hapësirave publike gjatë transportimit, për rastet kur kamionë të cilët transportojnë materiale ndërtimore, nuk janë të mbuluar.

Neni 12

Kundërvajtjet administrative në fushën e infrastrukturës publike

Për atë që nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e infrastrukturës publike, këto veprime:

1. Ndërhyrja në rrjetin rrugor, si:

- a. Dëmtim, çarje, ndotje dhe bllokim rruge.
- b. Dëmtim, çarje, trotuari dhe dëmtim bordure.
- c. Dëmtim, bllokim pusete, kunete,

2. Ndërhyrje në rrjetin elektrik rrugor si:

- a. Lidhjet e pamiratuara në shtyllat e ndriçimit, tabela, pemë, rrjetin ajror, etj.

- b. Dëmtim i shtyllave ndriçuese.
- c. Përdorimi i shtyllave si suport mbajtës/mbështetës për montimin e reklamave, kapjen e kablllove elektik, telefonik, internetit, etj.
- d. Dëmtimi i traseve kablllore, e linjave ajrore nga punimet që kryhen pranë tyre me ose pa leje, si dhe shkuljen e shtyllave.

3.Ndërhyrje në rrjetin e ujësjellësit si:

- a. Lidhjet e pamiratuara në tubacion.
- b. Dëmtimi i pusetave.
- c. Dëmtimi i tubacioneve nga punimet që kryhen pranë tyre, me ose pa leje.

4.Ndërhyrjet në hapësirat publike dhe të gjelbërta, si :

- a. Dëmtim i hapësirës publike dhe të gjelbërt,
- b. Prerja e pemëve, dëmtimi i gjelbërimit urban,
- b.Vendosje posterash reklamuese pa leje, në fasada, pemë, shtyllë, tabelash, pankartash, banderola pa leje,etj.

Neni 13

Kundërvajtjet administrative nga pronarët/kujdestarët, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike.

1.Për aq sa nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative nga pronarët/kujdestarët, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike, këto veprime:

- a. Të sigurojnë që në ambjentet e përbashkëta, në bashkëpronësi dhe hapësirat publike, kafshët/shpendët e tyre të mos paraqesin rrezik për njerëzit apo kafshët/shpendët e tjera, duke zbatuar detyrimin që:
 - Qeni duhet të mbahet nga pronari/kujdestari, me rrip jo më të gjatë se 1.5 metra.
 - Të vendosin maska mbrojtëse për qentë e rracave të rrezikshme: spic, hasky,rotvailer, pitbull, doberman, qeni i sharrit, pastor, kangalli turk, bokser, etj.
 - Të shmangin ndotjen e ambienteve të përbashkëta, në bashkëpronësi dhe hapësirat publike nga kafshët/shpendët e tyre, dhe në rast ndotje të pastrojnë ambjentin.
 - Personat të cilët, mbajnë kafshë/shpendë shtëpiake, të shoqërimit apo të luksit, në banesa individuale apo bashkëpronësi në zona të urbanizuara, janë të detyruar të mos lejojnë që ato të kryejnë ndotje dhe shkaktojnë zhurma, duke u bërë shqetësim për pjestarët e tjerë të komunitetit, duke cënuar gëzimin e qetë të pronës së tyre.
 - Mbajtja dhe tregtimi i kafshëve, bagëtisë apo shpendëve të çdo lloji, pavarësisht numrit të tyre, është e ndaluar brenda zonave urbane.
 - Mbajtja apo qarkullimi i kafshëve blegtorale jo shtëpiake, në mjedise publike të qëndrave urbane si : kuaj, lopë, dhen, dhi, derra, shpendë (pula), etj.

Neni 14

Kundërvajtjet administrative në fushën e kyerjes së aktivitetit tregtar pa licencë, autorizim apo leje përkatëse transporti.

1. Mospajsa me leje për zënien e hapësirës publike dhe zhvillimi i aktiviteteteve pa licencë, autorizim, apo leje përkatëse:
 - a) Zënie hapësire publike për shërbim me tavolina jashtë lokalit,
 - b) Veprimtari të ndryshme fitimprurëse ose promocionale që zhvillohen në hapësirat publike,
 - c) Shitje pa licencë e lëndëve djegëse pa licencë, për përdorim nga konsumatorët fundorë
 - q) Rezervimi i parkingut pa leje nga bashkia,
 - d) Transport udhëtarësh 1+4 dhe 1+8 pa licencë,
 - e) Lëvizje me mjete të tonazhit të lartë, pa licencë,
 - f) Hyrja pa autorizim në rrugët kryesore të qytetit i mjeteve të tonazhit të lartë,
 - g) Lëvizja e automjeteve në linja ndërqytetase dhe rrethqytetase që nuk respektojnë dispozitat ligjore,
- 2) Zënie hapësire për ekspozim malli,
 - a) Zënie hapësire publike nga tregtarët ambulante.
 - b) Lëvizja me autokarro, motokarro për transport mallrash pa licencë, autorizim apo leje përkatëse.
 - c) Mosrespektimi i orarit të përcaktuar për mjetet e licencuara të transportit publik.

Neni 15

Masat plotësuese në rast të zhvendosjes së automjeteve

Përveç pikës “ç”, të nenit 8 të këtij vendimi, “Braktisja e automjeteve dhe sendeve të tjera në rrugë, mjedise publike apo ambiente të përbashkëta”, por edhe në rastet kur drejtuesit e mjeteve shkelin kërkesat e kodit rrugor, duke parkuar automjetet në rrugë, të cilat janë të paisura me sinjalistikën ndaluese shoqëruar me atë të heqjes së automjeteve me karotrec, përveç gjobës për shkeljen administrative, duhet aplikuar si shpenzim administrativ shtesë edhe tarifa e zhvendosjes së automjetit kundërvajtës me karotrec.

Neni 16

Masat parandaluese për kundërvajtjet administrative

Përveç sanksionit administrativ të vendosur nga strukturat konstatuese për secilën nga kundërvajtjet e parashikuara në këtë vendim, kundërvajtësit mund të nënshtrohen edhe konfiskimit të sendeve mallrave që kanë shërbyer apo që ishin caktuar për të shërbyer si mjete për kryerjen e kundërvajtjes administrative të parashikuara në këtë rregullore.

KREU III

SANKSIONET ADMINISTRATIVE DHE MËNYRA E CAKTIMIT TË TYRE

Neni 17

Sanksionet/Aktet administrative

I. Sanksionet/Aktet administrative për kundërvajtjet e parashikuara në këtë vendim janë :

- a. Paralajmërim me shkrim/Akt konstatimi.
- b. Procesverbal për kundërvajtjet administrative, ku sanksionohet masa e gjobës.

2.Sanksioni “Paralajmërim me shkrim” është akt administrativ që ka për qëllim këshillimin, paralajmërimin dhe lënien e detyrës për kundërvajtësit, që jepet për një shkelje të një rëndësie të vogël dhe/apo kur ekzistojnë rrethanat lehtësuese.

3.Në rast përsëritje të kryerjes të së njëjtës kundërvajtje apo të një kundërvajtje administrative tjetër sipas këtij vendimi apo legjislacionit në fuqi, jepet sanksioni administrativ me gjobë.

Neni 18

Masa e gjobës për kundërvajtjet administrative kundër rregullave të bashkëjetesës shoqërore

Masat e sanksionit me gjobë për kundërvajtjet administrative të parashikuara në këtë vendim:

1..Për kundërvajtjet në fushën e rregullave të hapësirës publike të parashikuara në nenin 7, struktura konstatuese vendosin gjobë si më poshtë :

- Për individë 5 000(pesë mijë) lekë deri në 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë;
- Për persona fizikë, juridik publik ose privat si për herë të pare 10. 000 (dhjetë mijë) lekë edhe kur përsëritet me 20 000 (njëzet mijë) lekë .

2.Për kundërvajtjet në fushën e sigurisë të parashikuara në nenin 8 struktura konstatuese vendosin gjobë si më poshtë :

- Për individë 5 000(pesë mijë) lekë deri në 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë;
- Për persona fizikë, juridik publik ose privat si për herë të pare 10. 000 (dhjetë mijë) lekë edhe kur përsëritet me 20 000 (njëzet mijë) lekë.

3.Për kundërvajtjet të parashikuara në nenin 9, struktura konstatuese vendos gjobë nga 2.000 (dy mijë) lekë deri 5.000 (pesë mijë) lekë.

4.Për kundërvajtjet administrative të parashikuara në nenin 10, struktura konstatuese vendos gjobë nga 2.000 (dy mijë) deri në 5.000 (pesë mijë) lekë.

5.Për kundërvajtjet administrative në fushën e mjedisit të parashikuara në nenin 11, struktura konstatuese do të vendosë gjobë, si më poshtë :

- Për individë 5 000(pesë mijë) lekë dhe kur përsëritet 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë;
- Për persona fizikë, juridik publik ose privat si për herë të parë edhe kur përsëritet me 20 000 (njëzet mijë) lekë .

5.Për kundërvajtjet administrative në fushën e infrastrukturës publike parashikuar nga neni 12, struktura konstatuese vendos gjobë:

-Në masën 10.000 (dhjetë mijë), për konstatimet e parashikuara në pikën 1 të nenit 12.

-Në masën 20.000 (njëzet mijë) lekë, për konstatimet e parashikuara në pikat 2,3 dhe 4 të nenit 12.

6.Për kundërvajtjet administrative nga pronarët/kujdestarët, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambjentet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike të Bashkisë së Shkodrës, struktura konstatuese do të vendosë gjobë :

Në masën 2.000 (dy mijë) lekë për shkeljet e parashikuara në nenin 13, e cila dyfishohet në rast të përsëritjes së shkeljes brenda një periudhe 3 (tre) mujore, nga pronari / kujdestari i kafshëve/shpendëve.

7. Në masën 20.000 (njëzet mijë) lekë për shkeljet e konstatuara në pikën 1 të nenit 14, si dhe në masën 5.000 (pesë mijë) lekë për shkeljet e konstatuara sipas pikës 2 të këtij neni.

8. Në masën 4.000 (katër mijë) lekë, sipas nenit 15 të këtij vendimi.

8.Pavarësisht parashikimeve të pikës 4 dhe 5 të këtij neni, kur Policia Bashkiake konstaton në kryerje e sipër kundërvajtjen në fushën e infrastrukturës publike, vendos menjëherë dënimin me gjobë sipas parashikimeve të këtij vendimi dhe në çdo rast njofton strukturat përkatëse në varësi të Bashkisë Shkodër, për llogaritjen e dëmit dhe shpërblimin e tij nga kundërvajtësi. Në këtë rast Policia Bashkiake vendos në dispozicion të strukturave në varësi të Bashkisë Shkodër një kopje të procesverbalit të gjobës.

Neni 19

Shpërblimi i dëmit dhe përlllogaritja e tij

1.Nëse struktura konstatuese, konstaton shkaktim dëmi që vjen si pasojë e kundërvajtjes administrative, menjëherë pas vendosjes së gjobës për kundërvajtjet administrative, njofton strukturën përkatëse që është përgjegjëse për përlllogaritjen e dëmit të shkaktuar dhe dëmshpërblimit të tij.

2.Struktura përgjegjëse vlerëson masën e dëmit dhe me një akt administrativ më vete vendos masën në mënyrën e shpërblimit të dëmit.

3.Shpërblimi i dëmit kryhet nëpërmjet zëvendësimit apo kthimit në gjëndjen e mëparshme të pronës publike, sendit/objektit/hapësirës së dëmtuar ose duke paguar kundërvleftën monetare të dëmit të shkaktuar.

4.Strukturat përgjegjëse për shqyrtimin dhe përlllogaritjen e dëmit, është struktura e cila ka pësuar dëm në pronën të cilën ajo administron.

Neni 20

Mënyra e caktimit të dënimit

1.Sanksioni administrativ që zbatohet për çdo shkelje caktohet duke respektuar parimin e propocionalitetit në raport me sjelljen e konstatuar, dispozitat e ligjit për kundërvajtjet administrative mbi kriteret për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, si dhe dispozitat e këtij vendimi.

2.Nëse individi, personi fizik ose personi juridik publik/privat ka kryer më shumë se një kundërvajtje nga ato të parashikuara nga ky vendim, si dhe çdo akt tjetër nënligjor, dënimi jepet për çdo kundërvajtje.

3.Në rastin kur disa kundërvajtje të kryera nga i njëjti person, konstatohen dhe shqyrtohen nëpërmjet të njëjtit procesverbal, caktohet një dënim me gjobë që përbëhet nga bashkimi i dënimeve me gjobë për secilën kundërvajtje, por jo më shumë se 20.000 (njëzet mijë) lekë.

4.Nëse në kryerjen e kundërvajtjes kanë marrë pjesë më shumë se një person, dënimi jepet në mënyrë të veçantë për secilin kundërvajtës.

Neni 21

Rrethanat lehtësuese

1.Lehtësojnë sanksionin administrativ këto rrethana:

a. Kundërvajtësi shpreh pendesë për veprimin e kryer.

b. Kundërvajtësi ka eliminuar vullnetarisht pasojat e ardhura nga shkelja e kryer, ka kompensuar humbjen apo eliminuar dëmin e kryer.

- c. Kundërvajtja është kryer për shkak të rrethanave të rënda personale e familjare.
 - d. Kundërvajtja është kryer nga një grua shtatzënë.
2. Kur konstatohet se kundërvajtja administrative është kryer në rrethanat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, jepet dënim administrativ me paralajmërim ose dënim administrativ në minimum të masës së gjobës së parashikuar për atë kundërvajtje.

Neni 22 Rrethanat rënduese

1. Rëndojnë sanksionin administrativ këto rrethana:
- a. Kundërvajtësi vazhdon veprimtarinë e paligjshme edhe pas kërkesës për të ndërprerë atë.
 - b. Kundërvajtja është kryer nga më shumë se një individ apo grup individësh.
 - c. Kundërvajtja është kryer gjatë një fatkeqësie natyrore ose rrethana të tjera të gjendjes së jashtëzakonshme.
 - d. Kundërvajtja është kryer nën ndikimin e pijeve alkolike, narkotike apo psikotrope.
2. Kur konstatohet se kundërvajtja administrative është kryer në rrethanat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, jepet dënim me gjobë në një masë afër ose në nivelin maksimal të masës së gjobës së parashikuar për kundërvajtje.

KREU IV

KOMPETENCAT DHE PROCEDURA E KONSTATIMIT DHE SHQYRTIMIT TË KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE DHE ZBATIMI I TYRE

Neni 23

Kompetenca për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative

1. Strukturat konstatuese janë përgjegjëse për konstatimin dhe shqyrtimin e të gjithave kundërvajtjeve të parashikuara në këtë vendim, si edhe të çdo shkeljeje tjetër të miratuar nga Këshilli Bashkiak.
2. Kundërvajtjet administrative, sipas këtij vendimi, konstatohen dhe shqyrtohen gjatë veprimtarisë rutinë të ushtrimit të veprimtarisë së tyre ose sipas sinjalizimeve apo ankimeve të individëve dhe qytetarëve të ndryshëm.
3. Gjatë procedurës për konstatimin dhe shqyrtimin e një kundërvajtje administrative, strukturat konstatuese të Bashkisë Shkodër, nëse e sheh të nevojshme, ka të drejtë të kërkojë ndihmën e Policisë së Shtetit për kryerjen e kontrollit të identitetit të personit të dyshuar për kryerjen e kundërvajtjes, apo shkeljes së konstatuar.

Neni 24

Procedura e konstatimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve

1. Struktura konstatuese konstaton kundërvajtjet dhe e shqyrton atë menjëherë në vendin e kryerjes së saj.
2. Konstatimi dhe shqyrtimi i një kundërvajtje pasqyrohet në procesverbalin e kundërvajtjes, i cili përfshin, dënimin administrativ që jepet ndaj kundërvajtësit.
3. Përpara nënshkrimit të procesverbalit të konstatimit dhe vendosjes së gjobës punonjësi konstatues i shpjegon kundërvajtësit shkeljen faktike të kryer, bazën ligjore dhe konsiderimin e

saj si kundërvajtje administrative si dhe dënimin administrativ që zbatohet. Kundërvajtësit i jepet mundësia për të paraqitur, aty për aty, komentet dhe shpjegimet përkatëse.

4. Procesverbalin, si rregull, hartohet në prani të kundërvajtësit. Ai nënshkruhet nga punonjësi konstatues, kundërvajtësi dhe dëshmitarët e pranishëm, në rast se ka të tillë. Në rast kur kundërvajtësi nuk është i pranishëm, refuzon të nënshkruajë, nuk mundet të nënshkruajë apo refuzon të marrë procesverbalin, punonjësi konstatues bën një shënim të posaçëm në procesverbal dhe e vërteton këtë fakt nëpërmjet të paktën një dëshmitari.

5. Një kopje e procesverbalit i njoftohet kundërvajtësit nëpërmjet dorëzimit në vend. Në rastet kur kundërvajtësi refuzon të marrë kopjen e procesverbalit, ai konsiderohet i njoftuar. Në rastet kur kundërvajtësi nuk është i pranishëm, procesverbalin njoftohet sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

6. Dëshmitar, sipas pikës 4 të këtij neni, mund të jetë çdo person fizik me zotësi të plotë për të vepruar sipas përcaktimit të Kodit Civil, përfshirë këtu edhe një agjent tjetër konstatues.

Neni 25

Procesverbalin dhe baza e të dhënave

1. Modeli i procesverbalit për kundërvajtjet administrative dhe procesverbalin për shpërblimin e dëmit miratohet nga kryetari i Bashkisë në përputhje me dispozitat e ligjit për kundërvajtjet administrative.

2. Kryetari i Bashkisë, miraton rregullat për krijimin, administrimin e bazës së të dhënave për kundërvajtjet administrative, ku përfshihen, dhënësit e informacionit, ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave dhe nivelin e aksesit në këtë bazë të dhënash.

Neni 26

Zbatimi Vullnetar

1. Gjohet paguhen vullnetarisht brenda 10 ditëve, pas kalimit të afatit të parashikuar, zbatohet një kamatvonesë prej 2% (dy përqind) mbi masën e gjobës, për çdo ditë vonese. Shuma totale e kamatvonesave nuk mund të tejkalojë masën e gjobës.

2. Pagesa vullnetare e gjobës dhe/ose kamatvonesa bëhet me marrjen e fletë gjobës, dhe pagesën e vlerës së detyrimit pranë bankave të nivelit të dytë, apo pranë Filialit Posta Shqiptare, Sh.A Shkodër.

Neni 27

Ekzekutimi i dënimit për kundërvajtjet administrative, që parashikon dënimin me gjobë, si titull ekzekutiv

1. Vendimi për kundërvajtjet administrative, që parashikon dënimin me gjobë apo shpërblimin e dëmit, i vendosur nga strukturat konstatuese në zbatim të këtij vendimi përbëjnë titull ekzekutiv dhe ekzekutimi i tyre kryhet sipas legjislacionit në fuqi.

2. Në rast se nga aktet ligjore nënligjore nuk parashikohet ndryshe, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore është struktura përgjegjëse për ekzekutimin e detyrueshëm të tyre.

3. Të ardhurat nga gjobat dhe për kundërvajtjet dhe shpërblimin e dënimeve të parashikuara nga ky vendim, kalojnë tërësisht në buxhetin e Bashkisë së Shkodrës.

Neni 28

Procedurat e veprimit në rastet e kundërvajtjeve të tjera

Kur struktura konstatuese krijon dyshimin e arsyeshëm se një veprim ose mosveprim i një personi fizik apo juridik, përbën një kundërvajtje administrative, konstatimi dhe shqyrtimi i së cilës nuk është në kompetencën e saj dhe se nga ai veprim mund të shkaktohet një dëm i pariparueshëm dhe me pasoja të rënda ndaj interesit publik apo palëve të treta, për jetën apo shëndetin e njerëzve, kafshëve apo për mjedisin, punonjësi i strukturës konstatuese ka të drejtë të marrë masa për ndërprerjen e menjëhershme të veprimeve të kundërvajtësit dhe të njoftojë organin përkatës për shkeljen e konstatuar.

29

Dispozita kalimtare

Për sa nuk është parashikuar në këtë rregullore strukturat konstatuese dhe zbatuese i referohen sipas rastit akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.